

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINE- Departamenti për Krime të Rënda**, Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Beqir Kalludra, me bashkëpunëtorin profesional Driton Berisha, në çështjen penale kundër të akuzuarve A.D., Q.R., S.M., Sh.L., E.G., S.I., për shkak të veprës penale Mashtrimi në votime neni 180 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda PP/I nr.193D/2013 të dt.01.10.2015 pas përfundimit të shqyrtimit fillestar me dt.31.08.2018, në prezencën e prokurorit të shtetit Valdet Gashi, dhe të akuzuarve, po ashtu në të njëjtën ditë, morri dhe shpalli publikisht këtë:

### A K T G J Y K I M

#### **Të akuzuarit:**

**A.D.**, i biri i H.1 dhe N., e gjinisë B.1, i lindur me ..., në fshatin M. e P., komuna e F.K., ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i ... fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetasi Republikës së Kosovës, me nr. të letërnjoftimit ....

**Q.R.**, i biri i F. dhe Sh., i vajzërisë H.2, i lindur me ..., në fshatin S.1, B.2, tani me vendbanim në F.K. rr.“P.I.” nr...., i martuar, baba i ... fëmijëve, ka të kryer Fakultetin Filozofik, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. të letërnjoftimit ....

**S.M.**, i biri i I. dhe H.3, e gjinisë U., i lindur me ..., në fshatin Gj. i M., komuna e K., tani me vendbanim në F.K. rr. “B.B.” nr...., i martuar, baba i ... fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. të letërnjoftimit ...

**Sh.L.**, i biri i A. dhe L., e gjinisë K., i lindur me ..., në F.K., ku edhe tani jeton rr.“L.N.” pn., i martuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. të letërnjoftimit ....

**E.G.**, i biri i F. dhe E., e gjinisë S.1, i lindur me ..., në fshatin B.2, tani me vendbanim në F.K., rr.“R.B.” nr...., i martuar, baba i ... fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. të letërnjoftimit ....

**S.I.**, i biri i H.4 dhe S.2, e gjinisë K., i lindur me ..., në fshatin B.E., me vendbanim në F.K., rr “D.” nr...., i martuar, baba i ... fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. të letërnjoftimit ....

### JANË FAJTORË

#### **Sepse:**

Me datë 12.12.2010 gjatë mbajtjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në qendrën e vendvotimit 091E/02R, e cila gjendej në shkollën fillore “S.R.”, në F.K., të pandehurit

A.D., Q.R., S.M., Sh.L., E.G. dhe S.I. në bashkëkryerje me të pandehurën S.A.e cila gjendet në arrati kanë falsifikuar rezultatet e zgjedhjeve apo votimeve në Kosovë, në atë mënyre që me rastin e numërimit të zgjedhjeve apo votimeve në Kosovë, në atë mënyrë që me rastin e numërimit të votimeve të kandidatëve të subjekteve politike, kanë hequr edhe shtuar gjithsej 552 (pesëqind e pesëdhjetë e dy) vota, kandidatëve të preferuar, dhe atë nga kandidatët e subjekteve politike LDD 6(gjashtë) vota, AKR 42 (katërdhjetë e dy) vota, LDK 332 (treqind e tridhjetë e dy) vota, SLS 2, PDK 105 (dy) vota, PDAK 5 (pesë) vota, PDK 105 (njëqind e pesë) vota.  
-me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Mashtrimi në votime nga neni 180 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Prandaj, gjykata konform dispozitave 2, 3, 34,42, 43 lidhur me 38, 64 dhe 180 par.1 të KPK-së, si dhe nenit 359, 365, 366, 368, 450 dhe 453të KPPRK-së, i:

## **G J Y K O N**

**A.D.me dënim me burgim** në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 1 (një) viti, i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale.

**Q.R.me dënim me burgim** në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 1 (një) viti, i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale.

**S.M. me dënim me burgim** në kohëzgjatjen prej 3 (tre) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 1 (një) viti, i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale.

**Sh.L.me dënim me burgim** në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 1 (një) viti, i akuzuari nuk kryen vepër tjetër.

**E.G.me dënim me burgim** në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 1 (një) viti, i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale.

**S.I.me dënim me burgim** në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 1 (një) viti, i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale.

Detyrohen të akuzuarit që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale, aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, ndërsa shpenzimet e paushallit gjyqësor, secili veç e veç, shumën prej 20.00 (njëzetë) euro, brenda afatit prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, ka paraqitur aktakuzën PP/I nr.193D/2013 të datës 31.08.2018, kundër të akuzuarve A.D., Q.R., S.M., Sh.L., E.G., S.I., për shkak të dyshimit se kanë kryer në bashkëkryerje veprën penale Mashtrimi në votim nga neni 180 par.1 e lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar, me dt.31.08.2018, ku të akuzuarit A.D., Q.R., S.M., Sh.L., E.G., S.S., e kanë pranuar në tërësi fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale për të cilën janë akuzuar.

Meqë të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat epranimit të fajësisë për kryerjen e vepër penale, pranimi i cili është bërë vullnetarisht, pranimi i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se nuk përmban asnjë shkëlqje ligjore apo gabim faktik, Gjykata vlerësojë se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPPRK-së, që të pranohet deklarata e të akuzuarve për pranimin e fajësisë për kryerjen e kësaj veprë penale, dhe të njëjtën edhe e ka aprovuar, duke mos administruar asnjë provë lidhur me vërtetësinë e gjendjes faktike.

Ashtu që, bazuar në një gjendje të tillë të pakontestuar të fakteve, gjykata vërtetojë se në veprimet e të akuzuarve A.D., Q.R., S.M., Sh.L., E.G., S.I., manifestohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Mashtrimi në votime nga neni 180 lidhur me nenin 23 të KPK-së, ashtu që të akuzuarit shpalli fajtorë, dhe ua shqiptoj sanksionin penal përkatës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prokurori i shtetit në fund ka deklaruar se të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë dhe gjykata e aprovoi pranimin e fajësisë nga të njëjtit, i propozon gjykatës që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë të sanksionit penal të merr si rrethanë lehtësuese faktin se të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë për këtë vepër penale dhe i propozon gjykatës që të njëjtit ti shpall fajtorë dhe ti gjykoj sipas ligjit.

**I akuzuari A.D.** i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të sanksionit penal, si rrethana lehtësuese të vlerësoj faktin se i njëjti asnjëherë më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin, është penduar dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej ndonjë vepër tjetër penale, është mbajtës i vetëm i familjes, dhe i gjendjes së dobët ekonomike, andaj e lut gjykatën që t'ia shqiptoj një dënim sa më të butë të mundshëm.

**I akuzuari Q.R.** i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të sanksionit penal, si rrethana lehtësuese të vlerësoj faktin se i njëjti asnjëherë më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin, është penduar dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej ndonjë vepër tjetër penale, është mbajtës i vetëm i familjes, dhe është prind i tre fëmijëve, andaj e lut gjykatën që t'ia shqiptoj një dënim sa më të butë të mundshëm.

**I akuzuari S.M.** i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të sanksionit penal, si rrethana lehtësuese të vlerësoj faktin se i njëjti asnjëherë më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin, është penduar dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej ndonjë vepër tjetër penale, është mbajtës i vetëm i familjes, dhe i gjendjes së dobët ekonomike, andaj e lut gjykatën që t'ia shqiptoj një dënim sa më të butë të mundshëm.

**I akuzuari Sh.L.** i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të sanksionit penal, si rrethana lehtësuese të vlerësoj faktin se i njëjti asnjëherë më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin, është penduar dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej ndonjë vepër tjetër penale, është mbajtës i vetëm i familjes, andaj e lut gjykatën që t'ia shqiptoj një dënim sa më të butë të mundshëm.

**I akuzuari E.G.** i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të sanksionit penal, si rrethana lehtësuese të vlerësoj faktin se i njëjti asnjëherë më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin, është penduar dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej ndonjë vepër tjetër penale, është mbajtës i vetëm i familjes, prind i dy fëmijëve, andaj e lut gjykatën që t'ia shqiptoj një dënim sa më të butë të mundshëm.

**I akuzuari S.I.** i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të sanksionit penal, si rrethana lehtësuese të vlerësoj faktin se i njëjti asnjëherë më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin, andaj e lut gjykatën që t'ia shqiptoj një dënim sa më të butë të mundshëm.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të llojit dhe lartësisë së sanksionit penal për të akuzuarit, i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, të parapara sipas nenit 64 të KPK-së, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarit, vlerësoi faktin se të njëjtit e kanë pranuar fajësinë në mënyrë shumë të sinqertë, sjellja dhe qëndrimi i tyre shumë korrekt në gjykatë, pendimi i thellë i tyre dhe keqardhjen për veprën penale të kryer, premtimi i të njëjtëve se në të ardhmen nuk do të përsërisin asnjëherë këto veprime, pothuajse të gjithë të akuzuarit janë mbajtës të familjes disaanëtarëshe, të gjendjes së dobët ekonomike, ashtu që të akuzuarve secili veç e veç ua shqiptojë sanksionin penal përkatës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se një sanksion i tillë penal, është në përputhshmëritë plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj vepre penale dhe përgjesisë penale të të akuzuarve, dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarve dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit konform nenit 42 të KPK-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale kundër të akuzuarve, do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, duke pasur për bazë ndërlíkueshmërinë e veprës penale, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale si dhe gjendjen pasurore të të akuzuarit, konform nenit 450 par.3 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

#### GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Krime të Rënda  
PKR.nr.555/15, dt.31.08.2018

Bashkëpunëtor profesional  
Driton Berisha

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari  
Beqir Kalludra

#### **KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.